

## **Pozicion Vakant**

**Balkan Finance Investment Group**, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6,000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

**Balfin Real Estate and Hospitality** është pjesë e BALFIN Group dhe mbulon shërbime shitje & marketing në fushën e Real Estate dhe shërbime akomoduese në industrinë e turizmit duke ofruar në treg një ekspertizë të nivelit të lartë.

**Pozicioni:** Copywriter & Content Creator

**Departamenti:** Marketing

**Vendndodhja:** Tiranë

### **Përmbledhja e Pozicionit:**

Copywriter & Content Creator është përgjegjës për shkrimin e materialeve në gjuhën shqipe dhe atë angleze për fushatat e ndryshme të marketingut, që përfshijnë artikuj të ndryshëm, materiale për broshura, flyers, content për rrjetet sociale dhe Web-et e kompanisë. Gjithashtu redakton dhe korrekton materialet e departamentit që janë për publikim ose komunikim të brendshëm.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore:**

- Krijon tekste kreative dhe tërheqëse për fushatat e ndryshme të marketingut (copy texts).
- Krijon kontent dhe tituj që tërheqin vëmendjen e audiencës ( content writer).
- Shkruan artikuj rreth projekteve të kompanisë dedikuar për blog, mediat online, print dhe ato vizive.
- Krijon kontent për web-et e kompanisë në përditësimin me materiale të vazhdueshme.
- Redakton dhe korrekton tekstet e ndryshme të marketingut në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

### **Eksperiencat e punës:**

- Të ketë eksperiencë pune në fushën e marketingut më shumë se 2 vite.

### **Aftësi të tjera:**

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe (gramatika e saj);
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, përbën avantazh edhe njohja e gjuhës gjermane;

- Të ketë fjalor të pasur leksikor;
- Të ketë iniciativë dhe kreativitet;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe aftësi ndërpersonale;
- Aftësi organizuese dhe bashkëpunuese në grup.

**Mënyra e aplikimit:**

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit në adresën [hr@balfinrealestate.al](mailto:hr@balfinrealestate.al) me subjekt: **Copywriter & Content Creator**.

**Afati i dorëzimit: 05/06/2022**

\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".